



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.250/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Nenad Lazic dhe Zyhdi Haziri anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e organizatës BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Drenas, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

- I. **PRANOHET** si e bazuar ankesa e organizatës BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Drenas, i shqiptohet dënimi më gjorbë, në shumë prej 1,200.00 (*njëmijedyqind*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.
- II. **Urdhërohet** subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), që brenda afatit prej 24 orëve nga pranimi i këtij vendimi, që ta përmirësoj shkeljet e përcaktuar si në pikën -I- të dispozitivit të këtij vendimi, në të kundërtën mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i .

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 18.10.2017 nga organizata BIRN dhe Internws Kosova, me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal të Drenasit, Adem Bucolli nga radhët e PDK-së, në një foto të publikuar në faqen e tij në Facebook, ka përdorur fëmijë me qëllime të fushatës zgjedhore. Me këtë rast, parashtruesi i ankesës thekson se është shkelur neni 5.2 i Rregullës Zgjedhore nr.13/2013 të KQZ-së. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi në lidhje me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) të datës 19.10.2017, thekson se fëmiju i Adem Bucollit kandidat për Kuvend Komunal të Drenasit, e nxjerrë nga faqja e Facebook-ut, është bërë në shtëpinë e vet me fëmijun e vet. Më tej, ka kërkuar që të hidhet ankesa si e pa bazë. Në përgjigjen në ankesë subjekti politik PDK, nuk ka ndërmarrë masa përmirësuese me arsyetimin se pretendimet e ankuesit me asnjë rregull zgjedhore nuk janë të definuara.

Paneli, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoj shkresat lëndës konform dispozitës së nenit 117 paragrafi 2 i LZP-së, konstatoj se :

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografia e ofruar si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka vërtetuar se Adem Bucolli, kandidat për Anëtar të Komunës së Drenasit, nga radhët e subjektit politik PDK, ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, nga fakti se, kandidati në fjalë në foton e publikuar, e cila përmban elemente të fushatës zgjedhore, ka përdorur një fëmijë.

Nga dëshmitë e sipërcituara paneli në mënyrë të sigurt dhe padyshimtë, ka vërtetuar se nga subjekti politik PDK, me seli në Prishtinë, dega Drenas, janë bërë shkeljet e Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, nga fakti se, foto e publikuar me fëmijë përmbanë element të fushatës zgjedhore, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 5.2 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së e cila përcakton: *“Në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen personat që nuk i kanë mbushur 18 vjet”*.

Paneli me rastin e vendosjes se gjohës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat për rastin: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se PDK, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e tij ka mohuar shkeljen e supozuar. Mos ndërmarrja e masave përmirësuese ka ndikuar në lartësinë e gjohës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli po ashtu vlerësoi, se dënimi i shqiptuar ndaj subjektit në fjalë do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c), nenit 117.2 dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.250/2017 me datë 20.10.2017

Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së